REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 32/11 Prot. Vlorë, më 07.12.2020

**VENDIM**

**Nr. 02 , datë 27.11.2020**

**PËR**

**LEJE PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË PIJSHËM**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të VKM-së nr.550, datë 15.07.2020 "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes "Për përdorim të burimit ujor nëntokësor për ujë të pijshëm", për burimin e Klisharit, subjektit "Ujësjellës Kanalizime Dropull" Sh.a;

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**FLAMUR MAMAJ**

KËSHILLI I BASENIT UJOR-VJOSË - REPUBLIKA E SHQIPËRISË